



The British School of Kosova

Pozita: Koordinator/e për Cilësi

Vendi i punës: The British School of Kosova

Vende të lira: 1 (një)

Përgjegjësitë:

1. Planifikon, organizon dhe monitoron procesin e sigurimit të cilësisë së shkollës në bashkëpunim me drejtorin ekzekutiv të shkollës;
2. Udhëheq procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës në bashkëpunim me aktivet profesionale;
3. Në bashkëpunim me aktivat profesionale, sigurohet që të gjithë mësuesit kanë përgatitur planet e nevojshme vjetore dhe detyrime sipas kërkesave të udhëheqjes së shkollës dhe nevojave për zbatim me sukses të Kornizës Kurrikulare të Kosovës;
4. Kontrollon ditarët dhe librat amë;
5. Harton vlerësimin vjetor të mësuesve, ku përshkruan dhe përmbledh anët pozitive të veprimtarisë së tij vjetore dhe përmirësimet që duhet të arrijë në vitin pasues shkollor;
6. Përgatitë planin zhvillimor për mësuesit fillestar dhe i mentoron ata në 2 vitet e para të punës;
7. Punon statistikën në bazë lëndore duke analizuar arritjet e nxënësve. (Pas analizës suksessive dhe mundësinë e përmirësimit i diskuton me mësuesit dhe drejtorin ekzekutiv);
8. Përgatitë teste provuese për testin e arritshmërisë dhe maturës në koordinim me mësuesit;
9. Monitoron orët e mbajtura nga mësuesit në koordinim me drejtorin ekzekutiv;
10. Vendos standardet e performancës dhe është përgjegjës për zbatimin e Kornizës kurrikulare të Kosovës;
11. Pas analizës së bërë nga grupet punuese, koordinatori harton planin e përmirësimit të performancës së stafit në bashkëpunim me drejtorin ekzekutiv ku paraqitet nevoja;
12. Harton dokumente apo udhëzime të tjera të nevojshme për sigurimin e cilësisë;

Kandidatët e interesuar duhet të kenë:

- Kualifikim universitar të nivelit Master;
- Minimum 2 vite përvojë punë në fushën e sigurimit të cilësisë;
- Minimum 5 vite përvojë në mësimdhënie;
- Aftësi të shkëlqyeshme analitike dhe të shkrimit në gjuhën shqipe dhe angleze;
- Aftësi të shkëlqyeshme të përdorimit të pakos Microsoft office.

Kualifikimet e kërkuara:

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin duke përfshirë një CV, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës lidhur me përgatitjet shkollore dhe një letër motivuese. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet e kërkuara do të ftohen për intervistë.

Informata shtesë:

1. Dokumentacioni i kërkuar për aplikim dorëzohet fizikisht në The British School of Kosova tek administrata ose përmes e-mailit në: **info@britishschoolkosova.com**
2. Dokumentacioni dorëzohet në kopje dhe është i pakthyeshëm. Nuk japim përgjegjësi për dokumentacionin e dorëzuar në origjinal.
3. Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është **21.06.2022** ora **16:00**.